



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Olimpiada e gjuhës shqipe dhe e letërsisë

Faza II

Viti shkollor 2016-2017

Kjo skemë vlerësimi është orientuese.

Përgjigjet e nxënësve do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret e dhëna më poshtë. Secili kriter ka një total pikësh. Nxënësi duhet të shfaqë disa kompetenca për secilin kriter, të cilat qartësohen në tabelën përkatëse. Kjo tabelë shpreh në mënyrë të detajuar se çfarë duhet të përmbushë nxënësi për të marrë pikë të plota apo ndërmjetëse.

Rubrikat e vlerësimit (20 pikë)

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e marra në shqyrtim).
-Zhvillon idetë, duke përdorur detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes. **5 pikë**
- II. Organizimi:** përgjigja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **5 pikë**
- III. Përdorimi gjuhësor:** përgjigja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **5 pikë**
- IV. Saktësia gjuhësore:** përgjigja e dhënë respekton rregullat e drejtshkrimit, shenjave të pikësimit dhe shkronjës së madhe. **5 pikë**

Rubrikat e vlerësimit (15 pikë)

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe mban një pozicion të shprehur qartë. **3 pikë**
- II. Zhvillimi i ideve:** përgjigjja e dhënë përdorur detaje specifike, shembuj, ilustrime, të përzgjedhura me shumë kujdes. **3 pikë**
- III. Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat gjuhësore. **3 pikë**